



Data: 11.06.2026

SHPLLJE PËR APLIKIM

për një (1) ekspert të jashtëm për anëtarë të Komisionit të Pranimit në Institucionin tjetër shtetëror për pozitën: Drejtor Ekzekutiv - Nr. REF RN00019731;

Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në pajtim me dispozitat e nenit 48 paragrafit 3.3 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtar Publik, Ligjin nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik si dhe nenit 14 paragrafi 4.3, 6 dhe 10 të Rregullores nr.07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil fton të gjithë ekspertët e jashtëm (ofruesit jo publik të shërbimeve të punësimit, OJQ-të dhe/apo kompanitë e regjistruara në Republikën e Kosovës në fushën e burimeve njerëzore) të dërgojnë ekspertët e tyre për anëtarë të mundshëm të Komisionit të Pranimit në Institucionin tjetër Shtetëror.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Eksperti i jashtëm do të jetë anëtar të Komisionit të Pranimit në kuadër të Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe duhet t'i plotësojnë kriteret si më poshtë:

Kriteret e kërkuara:

- Të kenë diplomë universitare të arsimit të lartë të nivelit të parë (bachelor), kurse për diplomat e marra jashtë vendit, nevojitet nostrifikimi;
- Të kenë tetë (8) vite përvojë pune profesionale prej të cilave të paktën pesë (5) vite në pozita të nivelit drejtues;
- Të mos jetë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike;
- Të mos jetë i dënuar për kryerjen e një veprë penale me dashje;
- Të mos jetë i punësuar në shërbimin civil;
- Të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore, si dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi për shkelje të rëndë në institucionin publik.

Pagesa:

Anëtari i Komisionit si ekspert i jashtëm në Komisionin e Pranimit, përfiton një pagesë fikse prej dyqind e pesëdhjetë (250.00) Euro për çdo procedurë të rekrutimit në të cilën merr pjesë në përputhje me nenin 14 paragrafi 10 të Rregullores nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet ti dorëzojnë edhe dokumentacionet si më poshtë:

- CV-në;



- Dëshminë e kualifikimit profesional (diplomën e fakultetit). Për edukimin e marrë jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Dëshmi që nuk është i dënuar për kryerjen e një vepre penale;
- Deklaratën se nuk ka qenë anëtarë i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pesë (5) vitet e fundit;
- Deklaratën se nuk është i punësuar në shërbimin civil, se nuk është i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore;
- Dëshmi që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Ekspertët e jashtëm mund të aplikojnë përmes postës elektronike dhe dokumentet e kërkuara t'i dorëzojnë në Agjencinë hr@pak-ks.org

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta dhe inkurajojmë ekspertët e jashtëm që të aplikojnë me kandidatët që i plotësojnë kriteret e shpalljes.

Shpallja mbetet e hapur nga data 12/06/2026 deri më 18/06/2026 në ora 16:00.

Për informata shtesë ose sqarime mund të kontaktoni në e-mail adresën: hr@pak-ks.org